

Nr. 01-328
Data: 09.07.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e katërt të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **13.07.2018** (e premte) duke filluar në orën **10:00**.

R e n d i d i t ē s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raport nga Drejtoria e shendetësisë dhe mirqenjes secale rreth gjendjës në ambulantat e në veqanti QKMF-së në Novobërdë dhe asaj në Llabjanë;
3. Problemi i transportit publik në Komunen e Novobërdës;
4. Asfaltimi i rrugës në fshtin Bostan;
5. Problemet me ujra të zeza në fshatin Bostan;
6. Të ndryshme;

Me: 09.07..2018
Në: Novobërdë



Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 11.06.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Abdyl Gashi, Dobrivoje Djordjovic, Jorgovanka Filic, Behare Jashari, Aleksander Pavic, Xhevati Mehmeti, Nënkyryetari i Komunës Sinisa Dmic, Zv.Kryesuesi i kuvendit për komunitete Bajrush Ymeri, dhe përfaqësuesit e UNMIK-ut.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendetë të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raporti i punës së Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete;
3. Të ndryshme;

Shpresa Kqiku i njoftoi antarët e komiteti se pas pikës së dytë e kan edhe një pikë shtes: Diskutimi dhe aprovimi i planit të punës së komitetit për komunitet.

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend ditë?

Pasi nuk pati propozime rendi i ditës u aprovua njëzëri nga anëtarët e Komitetit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbale u aprovua njëzëri nga anëtarët prezent të Komitetit.

Pika e dytë: Raporti i punës së Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitet;

Shpresa Kqiku për këtë pikë ja dha fjalen Shefes së zyres komunale për Kthim dhe Komunitete znj.Jasmina Denic.

Jasmina Denic pasi përshendetë të pranishmit tha: do tju prezantoj reportin gjatëmujor të punës së zyrës tonë, ZKKK në bazë të rregullores së punës ka punuar në tri fazë: kthimi i qëndrueshëm, kthimi i personave të riatdhesuar dhe qështjet e komuniteteve. Sa i përket kthimit të qëndrueshëm kemi punuar me organizata të ndryshme dhe Ministrin për Kthim, çdo ditë pranojmë kërkesa për kthim, sa i përket kthimit me organizata të ndryshme dhe Ministrin për Kthim kemi vizituar raste në terren dhe kemi mbajtur në mënyr të rregullt takimet si dhe konsultimet më partneret, gjatë kësaj periudhe tri familje kan shprehur dëshiren që të kthehen, 2 janë të regjistruara, gjatë kësaj kohe kemi bërë edhe shkallën e vlersimit të këtyre familjeve që kan qenë të regjistruara për kthim, gjithashtu në këtë periudhë kemi vizituar 5 familje të cilat kanë mrrë ndihmë ose janë në listen që presin për ndihmë. Pasi që kemi antarë të ri në komitetin për komunitete tju informoj më shumë pasi që antarë të cilët kan

qenë më heret e din se shkojn këto procedura, identifikimi i shkallës të të kthyerve përfshin një pasqyr komplet familjes që dëshirojnë të kthehen jo vetem problemin e kthimit por edhe problemin e dokumenteve dhe problemet rreth regjistrimit në shkoll si dhe ndihma për paraqitje ne ZKKK apo ndonjë ndihmi për hartimin e ndonjë planit të biznesit, kështu që ZKKK në të gjitha fushat ka ndihmuar. ZKKK ka punuar rreth projekti për ndërtimit të shtëpive, ky projekt do të jetë i realizueshëm në periudhë të ardhshme, kemi nenshkuar memorandum bashkpunimi ne mes të Komunës dhe IOM ku është i formuar edhe një komision i pavarur nga Kryetari i Komunës që e përcjell punën e tij. Gjithashtu kem vizituar familjet ne Serbi të cilat dëshirojn të kthehen ku janë përfshi 24 familje, këto janë familjet që kan shprehur dëshiren të kthehen dhe janë zgjedhur 9 familje për fazën e parë. Kryetari ka marrë pjesë në nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve, për 5 familje puna ka filluar kjo është sa i përket fazës së parë të projektit. Ne kemi filluar me rundin e dytë të fazës së parë por nuk ka diçka përfundimtare, e kemi pasur mundësin ne DRS projekt por nuk kemi mundur ta shfrytëzojm dhe këto projekte kanë shkuar në Komuna tjera por i kan disa kursime të cilat në të ardhmen do të mundë ti shfrytëzojm gjithashtu është edhe një projekt tjeter për ndërtim në kategorin e tretë në këtë projekt kemi propozuar 2 familje të cilat janë më prioritare. Kemi marrë pjesë në takime të organizuar nga organizata DRC lidhur me prodhimin e alokoholit vendor dy familje nuk kan pasur paisje për prodhim të alkoholit pasi që i kanë dhënë në shfrytëzim. Sa i përket statistikave 20 familje janë të paraqitura, 24 nga faza e parë, për aplikues 56, Fondi Qendror i Ministris për kthim ka përzgjedhur 12 raste që kanë nevoj për kthim. Sa i përket kthimit të riatdhesuar nuk kemi raste, ndërsa sa i përket kthimit të riatdhesuar ky projekt është pak problem pasi që rregullorja po ndërron çdo tre muaj. ZKKK ka marrë pjesë në takime të ndryshme si shpronsim të pronës, UNHACER ka dhuruar disa pako ndihmë, sa i përket dialogut multietnik kemi puuar një plan aksional, në këtë kohë është kryer edhe një vizit trashigimore e objekteve kulturore dhe të gjitha këto aktivitete ka financuar OSBE, lidhur me dialogun ndëretnik do të mbahen edhe dy puntori. Sa i përket grupit të grave UNMIK-u në bashkpunim me organizaten Shtëpija jonë ka përgaditur puntori lidhur me pajtimin dhe përafrimin e grave ku kemi marrë pyetje, kërkesa dhe rekomandime të ndryshme.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Zv.Kryesuesi Bajrush Ymeri pasi përshendetë të pranishmit tha: u mundova me ndëgju me vëmendje Shefen e ZKKK, e falemenderoj për raportin por ju paraqitet raportet e juaja dhe besoj që punët, angazhimet dhe financimet bëhen pa asnje dallim, por unë e kam një pyetje konkrete pasi që më intereson të dij në të gjitha këto aktivitete që janë bërë a ka edhe antarë nga komuniteti shqiptarë dhe rom apo vetem nga komuniteti serb sepse kemi raste kur ka të kthyer edhe nga komuniteti shqiptarë e një shembull të till po e përmendi me emër Raif Sylejmani nga fshati Makreshë i cili është kthyer nga Gjilani në fshat dhe me mundë e sakrific të madhe po e mban familjen e tij dhe kërkesa e vetme e këtij ka qenë rruga me ju rregullu jo me ju asfaltu pasi qe i ka afër 200m nga rruga kryesore por është e pakalueshme dhe shumë e dëmtuar.

Jasmina Denic tha: gjithmon kem probleme lidhur me komunitetin shqiptar dhe rom, kemi pasur tri kërkesa por nuk janë aprovu, janë vizituar këto familje prej Ministrisë janë ndihmuar disa familje me pako ushqimore por sa i përket qështjes së rrugëve kjo është Zyre e Kthimit dhe nuk mundë ta zgjedh atë problem.

Zv.Kryesuesi Bajrush Ymeri tha: po të kuptoj unë shumë mirë por meqenëse ne jemi komunitet pakic (shqiptarë dhe rom) duhet të mirreni me këtë qështje, pasi që në të gjitha komunat tjera është ndryshe, ne llogaritemi si komunitet pakic në Komunën e Novobërdës a nfakt komunitet pakic është komuniteti serb ne zyren e komunitetve dhe të gjitha benificacionet i merr komuniteti pakic andaj është mirë që të përfshihen edhe komuniteti shqiptarë pasi që keni kërkesa edhe nga komuniteti yne, ne nuk mundë të bisedojm më Ministrin për Kthim as me organizata të ndryshme që ndimojn zyren e kthimit por jeni ju ata që mundë të bisedoni dhe është mirë që ta përcjellni këtë kërkes.

Jasmina Denic tha: pajtohem plotëshishtë me diskutimin tuaj por sa i përket organizatat ndërkombe të komunitetit serb e njohin si komunitet pakic.

Abdyl Gashi pasi përshendet të pranishmit tha: po pajtohem me zv.Kryesuesin e Kuvendit, unë e kuptoj që problemet janë në nivel qendror, si pasoj e decentralizimit jemi në këtë situat mirëpo për komunitetin shqiptar nuk është e drejt të shkëlet dhe të anashkalohet, po dal jasht teme por meqense jemi antar të komitetit për komunitete po e ceki postin e Nenkrytarit të Komunës për Komunitet i cili ende nuk është zgjedhur, të pakten të kemi edhe ne përfaqësuesin tonë në mënyr që në çdo moment të kërkojm përgjegjësi kur na cenohet e drejta.

Pasi nuk pat diskutime tjera Raporti i punës së ZKKK u aprovua njëzëri nga gjithë antarët e Komitetit për komunitete.

Pika e tretë: Diskutimi dhe aprovimi i planit të punës së komitetit për komunitet;

Zv.Kryesuesi Bajrush Ymeri tha: kam diskutuar edhe në mbledhje të kaluar, pasi takimit që kemi pas ne Prevall së bashku me Jorgovanken dhe Shpresen kemi hartuar një plan të punës, më herët ky komunitet nuk ka pasur plan të punës andaj ne u munduam ta hartojm një të tillë, faktikisht ju do të duhej të takoheni prej mbledhjes së fundit që kemi pasur dhe te diskutoni për këtë plan por nuk keni pasur kohë por e keni në formë të shkruar jo ndoshta ideal por ka mundësi që ju të jepni sugjerimet dhe vërejtjet tuaj pasi që është një draft plan dhe në bazë të këtij ju do të punoni në të ardhmen, pasi që jemi pak vonë duhet ta kemi një plan të punës, nese keni ndonje paqartësi mundë ti paraqitni.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Aleksander Pavic pasi përshendetë të pranishmit tha: po pyes se këtë draft plan a e aprovon Kuvendi Komunal?

Bajrush Ymeri tha: nuk besoj që duhet ta aporvoj Kuvendi pasi që është plan i Komitetit për Komunitete, ju e keni për obligim një herë në viti ti raportoni Kuvendit Komunal për punën që e bëni por jeni të pavarur në hartim të planit dhe të punës tuaj.

Pasi nuk pat diskutime tjera aprovohet njëzëri plani i punës së komitetit për komunitete.

Pika e katërt: të ndryshme;

Aleksander Pavic tha: kur të dergohet rendi i ditës me pika të propozuara të na dërgohet edhe materiali në mënyr që të dim se për çka po diskutohet.

Bajrush Ymeri tha: kërkesa është e drejt e antarit të komitetit që para se të vij në mbledhje ta këtë materialin dhe të dij se për çka po diskutohet, kjo kërkesë i drejtohet Kryesueses së Komitetit, për at arsyë kam kërkë edhe në takimin që kemi pasur me OSBE-en dhe po kërkoj edhe prej juve dhe Kuvendit Komunal që Kryesueses se komitetit për komunitete ti shtohet pagesa, pasi që nuk mundet të jetë e barbart me juve në pagesë pasi që kjo ka obligime dhe për ti derguar ty rendin e ditës me të gjith materialin që e ka duhet të vij disa herë në Komunë, me këtë plan të punës të cilin e aprovuat e ka për obligim të marrë pjesë në çdo mbledhje të KPF dhe të Kuvendit Komunal dhe nese duhet në të gjitha takimet të merr pjesë dhe Kryesuesja udhëton prej fshatit Pasjak kjo krijon shpenzime dhe duhet të ketë kompenizm më ndryshe nga ju.

Jasmina Denic tha: rapporti i zyres se komiteve nuk është votuar asnjëher vetem është shqyrtauar dhe nuk ka pasur nevoj të aprovohet.

Dobrivoje Djordjevic pasi përshendetë të pranishmit tha: të mos votojm diçka që nuk duhet vetem të na dërgohet materiali për shqyrtim.

Abdyl Gashi tha: pajtohem me këtë plan të punës, sa e kuptova është për këtë vit dhe për vitin e ardhshëm do të kemi një plan tjeter të punës, ne gjithashtu kemi të drejt ta plotësojm dhe ndryshojm këtë plan të punës dhe mundë të kemi pika të ndryshme që mund ti shtyjm në asamblen Komunale në mënyr që mos te jemi një komitet ku debatojm, analizojm por nuk biem asnjë rezultat në fund.


Aleksander Pavic tha: sa i përket planit të punës dhe pagesës së Kryesues at që tha zt.Bajrush Ymeri mundë ti kompenzohet me meditje apo në ndonjë formë tjeter, nese Komuna nuk ka mundësi për

kompenzim atëher kisha kërku qe ne antarët tjer ta zavendësojm ndonjëher në mbledheje të Kuvendit në mënyr që mos të dëmtohet vetem ajo.

Abdyl Gashi tha: pasi që Kryetari i komunës nuk është këtu por është Nenkryetari kisha kërku scharim për mosgjedhje të Nënkytarit të Komunës për Komunitete apo ndoshta do të zgjidhet në këtë mbledhje të asambles komunale, kjo është shumë e rëndësishme për qytetarët pasi që e ndien veten shumë të anashkaluar pasi që nuk ka përfaqësues të komunitetit shqiptar.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi ne ora 11:00

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



DREJTORIJA E SHËNDETSIS/DIREKTORAT ZDRAVSTVA

Të nderuar,

Kryesuesja e Komitetit te komuniteteve, në bazë të kërkesës së pranuar dhe pikës së propozuar nga anatarët e Kom.Komit. simbas kësaj kërkese për mbledhjene që do të mbahet me 13.07.2018, ku keni kërkuar një raportë për gjendjen në Ambulancat e në veqanti për QKMF, në Novobërdë dhe Llabjanë, dëshiroj tju informoj se ne si Drejtori kompetente për shëndetsi dhe mirqenje socijale në teritorin e komunës se Novobërdës, në kuadër të administratës komunale, dhe kemi bërë gjithqka që është e mundur dhe që është në domenin tonë, si dhe mundësia Finacijare të vet Drejtoris.

Shpresoj se Ju si antarë të Kom.Komuniteteve e keni parasyshë situatën e tërsishme në komunë sa i përket Bugjetit, i cili është shumë i ulët dhe i pamjaftueshëm për komunën tonë e edhe për shëndetsi.

E në anën tjetër duke e pasur parasyshë edhe nevojat e mëdha të qytetarve tanë nga pjesë e teritorit tonë: Boljevce, Carevce dhe lagjeve tjera të përafërtë, i kemi ndërmarrë hapat e nevojshme, dhe jemi në fazën përfundimtare ta hapim Ambulancën e rre në fshatin Bolevcë, për nevoja të një numri t'emadhë të qytetarve (në numër të madhë qytetarë të vjetër).

Nëse tani fillojmë furnizimin e të gjitha Qendrave Sëndetsore në teritorin e Komunës së Novobërdës, në bazë të kërkesave, atëherë koj ambulancë do të mbetet pa mbuluar. Prandaj i kemi njoftuar të gjithë dhe ju kemi ndihmuar në bazë të emergjencave që i kanë pasur, do të thotë qendrat shëndetsore, që të gjejnë zgjedhje afatshkurte, pasiqë sigurishtë deri në fundë të muajit të gjithë do të pranojnë materialin e nevojshëm për punë normale.

Ne si Drejtori i kemi ndërmarrur të gjitha hapat e nevojshme që ti furnizojmë sa më parë që është e mundur.

Ju falenderohem që jeni të brengosur për këto lshime, por shpresojmë se deri në fundë të muajit do të flasim vetëm për suksese.

Sinqerishtë i Juaji, Drejtori, z.Tomsilav Stankovic.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Me respekt,


I drejtohem Kryesueses së Komitetit për Komunitete dhe antarëve të Komitetit, ne si Drejtori e Sherbimeve Publike pran kuvendit Komunal të Novobërdës tju informojm rreth qështjes së ngritur në Komitetit tuaj rreth problemit madhor të transportit publik i cili po na ndjek me vite të tëra - që nga paslufta dhe i cili problem ka qenë i zgjidhur në përiudha të caktuara kohore fatkeqësishtë afatshkurta.

Që nga muaji tetor 2017 ne si Drejtori kemi adresuar këtë problem dhe kemi dërguar kërkes me shkrim si drejtori e sherbimeve publike për të cilin veprim ka qenë i informuar me kohë edhe Nenkryetari i Komuniteteve zt.Bajrush Ymeri i cili ka qenë i informuar për çdo hap rreth këtij problemi. Për të njejtin problem ka qenë kemi biseduar dhe ka qenë e angazhuar edhe shefja e ZKKK.

Edhe pas takimeve të shumta me Ministrin e Infrastruktures, si dhe me Kryeministrin e Qeverisë dhe premtimave të shumta të marra fatkeqështë ky problem edhe sot e kësaj dite nuk është i zgjedhur.

Ne si Drejtori edhe më tutje e kemi prioritet këtë qështje dhe iden për zgjidhje të këtij problemi e kemi evidentuar edhe te donatorët e mundshëm.
Ju faleminderit për mirëkuptim, çfarë do propozimi dhe sugjerimi që kemi ne do të punojm në këtë drejtim.

Ju përshendesim!





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Me respekt,

I drejtohem Kryesueses së Komitetit për Komunitete dhe antarëve të Komitetit, ne si Drejtori e Sherbimeve Publike pran Kuvendit Komunal të Novobërdës tju informojm rreth qështjes së ngritur në Komitetit tuaj rreth problemit të asfaltimit të rrugës se ky problem i kësaj pjesë të rrugës nga rruga kryesore në lagjen e komunitetit rom në fshatin Bostane.

Tju informoj edhe sotë se kjo pjesë e rrugës do të asfaltohet në kuadër të projektit Asfaltimi i Rrugëve Lokale ne teritorin e Komunës së Novobërdës.

Procedura kto të cilat besoj se do të përfundojm deri në fund të shtatorit. Duke pasur parasysh se të gjitha punët administartive të nevojshme për fillimin dhe përfundimin e projektit i kemi përfunduar.

Sinqerisht e juaja D.SH.P zonj. Shefikje Mehmeti.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Me respekt,

I drejtohem Kryesueses së Komitetit për Komunitete dhe antarëve të Komitetit, ne si Drejtori e Sherbimeve Publike pran Kuvendit Komunal të Novobërdës tju informojm rreth qështjes së ngritur në Komitetit tuaj rreth problemit të ujërave të zeza në fshatin Bostan nuk është i tanishëm është para një kohe mirëpo nuk kemi mundur ta zgjedhim si problem individual të një lagje duke pasur parasysh se Komuna nuk ka Kompani të veten dhe pamundësia e shpalley së proceduarve të tenderimit për një vlerë të vogël ne si Drejtori kemi shpallur tender për tërë teritorin e Komunës për sanimin e prishjeve dhe bllokimin e sistemit egzistues të rrjetit të ujrate të zeza.

Andaj shpresojm se pas kryerjes së proceduarave dhe obligimeve ligjore do të zgjidhen të gjitha problemet e ujrate të zeza, në tërë teritorin e Komunës sonë.
Shpresojm se edhe ky problem do të zgjithet deri ne mesin e muajit të ardhëshum.

Sinqerisht e juaja

Drejtoresha e Sherbimeve Publike
Shefkije Mehmeti.

